

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	TEC-et lundruese dhe mbetjet e rrezikshme/ KESH paguan edhe për trajtimin e mbetjeve të “Tigrave”
ADRESA	https://piranjat.al/investigime/tec-et-lundruese-dhe-mbetjet-e-rrezikshme-kesh-paguan-edhe-per-trajt-i104991
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 12:10:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 11:55:01 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	96929c11a19ea1dae3ddba95e56befba6a023421173f09c63776272d8e9c557b
TEKSTI	a888fce5024566eaa911a0f7a1927ea7ec2fc793ce161d4904a8451551ef282c
PAMJA	77588282a51473c853017cb1bd53bac37ed8fc1971158d681f5dea29d08fedbc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3c383b38c8be5147a73e9ff74f4c300dd3ab1fb773baa5173a133f8a987fc0b5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	d62161966812e333892ed1a12b4b718f8d0962907bcb93c104eb3485a382e6f9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3c383b38c8be5147a73e9ff74f4c300dd3ab1fb773baa5173a133f8a987fc0b5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

alarm në Kishinau

identifikuar që fluturuan në ...

paguan edhe për traitimin e

në zonën e Triportit

punimi i diplomës rezulton

ministres së Shëndetësisë. E cilësuar ...

te ruar ne darkën për Xi Jinnin

javën e ardhshme në ...

e vëllat te Ferit Hoxhës

per mirëmb e sist

INVESTIGIME

TEC-et lundruese dhe mbetjet e rrezikshme/ KESH paguan edhe për trajtimin e mbetjeve të “Tigrave”

Piranjat Përditësimi i fundit 19 Shtator 2026, 13:55



Dy TEC-et lundruese “Tigri 1” dhe “Tigri 3”, të ankoruara në zonën e Triportit në Vlorë, nuk kanë qenë në qendër të vëmendjes vetëm për kostot e tyre të larta, por edhe për pasojat mjedisore që lidhen me funksionimin e tyre. Të kontraktuara në vitin 2022, në kulmin e krizës energjetike, dy anijet me gjeneratorë termikë u paraqitën si një zgjidhje emergjente për prodhimin e energjisë elektrike.

Por ato nuk u vunë në punë gjatë periudhës së parë të krizës, ndërsa kostot e projektit kanë vijuar edhe pas kalimit të emergjencës energjetike.

Sipas të dhënave të bëra publike gjatë raportimeve të mëparshme, deri më tani **KESH ka paguar dhjetëra milionë dollarë për qirarë dhe operimin e dy TEC-eve. Kontratat parashikojnë pagesa të tjera deri në përfundimin e tyre**, ndërsa mbi këto shpenzime shtohen edhe kostot për karburantin dhe menaxhimin e mbetjeve.

Pikërisht kjo e fundit është një tjetër faturë që tashmë i është shtuar projektit.

KESH ka hapur një tender për lidhjen e një marrëveshjeje kuadër 24-mujore për “Menaxhimin e mbetjeve të projektit të gjenerimit termik ‘Implanti Lundrues i Përkohshëm dhe Infrastruktura Ndihmëse”.

Në dokumentet e procedurës përcaktohet se implanti termik lundrues prodhon si “mbetje të rrezikshme”, ashtu edhe “mbetje jo të rrezikshme”.

Mes mbetjeve të klasifikuara si të rrezikshme janë vajrat lubrifikantë sintetikë, mbetjet e zifit dhe bitumit, llumrat e naftës, si dhe dhera e gurë me përmbajtje të rrezikshme.

Sipas të dhënave të tenderit, bëhet fjalë për menaxhimin e mbetjeve që do të krijohen nga përdorimi i rreth 15 mijë tonëve lëndë djegëse HFO, ose mazut. **Nga kjo sasi parashikohet të krijohen rreth 488.8 tonë sllazh dhe ujëra vajore, ndërsa 29.6 tonë janë mbetje të vajrave lubrifikantë.**

Për transportin dhe trajtimin e këtyre mbetjeve, **KESH parashikon të paguajë rreth 350 mijë euro me TVSH.**

Kjo do të thotë se, përveç kostove të qirarës, operimit dhe karburantit, buxheti i korporatës duhet të përballojë edhe faturën për menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga funksionimi i TEC-eve.

Çështja e ndotjes së mundshme nga dy anijet është ngritur që prej momentit të mbërritjes së tyre në Vlorë. Ambientalistë dhe qytetarë kanë kundërshtuar përdorimin e TEC-eve lundruese në Gjirin e Vlorës, duke ngritur shqetësime për pasojat e djegies së karburantit, mbetjet hidrokarbure dhe ndikimin që mund të kenë proceset e operimit në ekosistemin detar.

Sistemi i gjenerimit termik në këto impiante bazohet në djegien e lëndës djegëse për prodhimin e energjisë. Procesi shoqërohet me mbetje të ndryshme, ndërsa për ftohjen e pajisjeve përdoret uji i detit, i cili më pas shkarkohet përsëri në mjedisin detar. **Një nga ambientalistët që ka ngritur prej fillimit shqetësimet për ndikimin mjedisor të TEC-eve është Lavdosha Ferruni, i cili ka kundërshtuar përdorimin e tyre në një zonë turistike si Gjiri i Vlorës.**

Në vitin 2022, ministria e atëhershme e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku, deklaroi se dy anijet plotësonin standardet mjedisore dhe se ishin të certifikuar nga Banka Botërore. Më pas, Banka Botërore mohoi se kishte certifikuar vetë impiantet për respektimin e kushteve mjedisore.

Ndërkohë, edhe llogaritjet ekonomike kanë ngritur pikëpyetje për koston e energjisë së prodhuar nga këto TEC-e.

Sipas përlogaritjeve të paraqitura më herët nga Piranjat, për të prodhuar një megavat-orë energji nevojiten rreth 229 kilogramë mazut. Me 15 mijë tonë karburant, prodhimi teorik do të ishte rreth 65.5 mijë megavat/orë.

Vetëm për blerjen e kësaj sasive karburanti janë llogaritur rreth 9 milionë euro.

Kjo e çon koston e prodhimit të energjisë, pa përfshirë qiranë dhe operimin e anijeve, në rreth 138 euro për megavat/orë.

Ndërkohë, shifrat e publikuara së fundmi tregojnë se TEC-et kanë prodhuar rreth 110 mijë megavat/orë energji që prej nisjes së prodhimit në vitin 2024, ndërsa kostot e mbajtjes së tyre kanë vijuar të jenë të konsiderueshme.

Pra, përtej debatit mbi leverdinë ekonomike të projektit, tashmë në skenë është edhe një tjetër element: menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme që krijohen nga funksionimi i tij.

Dhe pikërisht këtu vjen zhvillimi më i fundit.

Më 3 shtator 2026, Enti Rregullator i Energjisë pezulloi procedurën për rilicencimin e KESH për prodhimin e energjisë nga “Tigri 1” dhe “Tigri 3”. Sipas ERE-së, pezullimi do të vijojë deri në sqarimin nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit nëse dy TEC-et kanë leje mjedisore të vlefshme për operimin e tyre.

Kështu, ndërsa KESH po përballon një tjetër faturë për menaxhimin e mbetjeve të prodhuara nga TEC-et, mbetet për t’u sqaruar edhe statusi i lejeve mjedisore që lidhen me operimin e tyre.*/piranjat news*

Të gjitha të drejtat e këtij materiali janë pronë ekskluzive dhe e patjetrësueshme e Piranjat.al sipas ligjit Nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”. Ndalohet kategorikisht kopjimi, publikimi, shpërndarja, tjetërsimi pa autorizimin e Piranjat.al në të kundërt çdo shkelës do të mbajë përgjegjësi

Artikuj te sugjeruar

INVESTIGIME 19 Shtator13:52

[“Ministrja kopjace”/ Klodiana Spahiu në krye të Shëndetësisë, punimi i diplomës rezulton plagjiaturë](#)

Të mërkurën e 2 shtatorit 2026, zonja Evis Sala dha dorëheqjen nga posti i ministres së Shëndetësisë. E cilësuar ...

INVESTIGIME 18 Shtator22:42

[“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit](#)

Jemi në Tiranë, në rrugën e Durrësit, aty ku një apartament është kthyer në “mollë sherri” dhe ka ...

INVESTIGIME 18 Shtator22:25

[Tmerri i 40-vjeçares në Vlorë/ Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet](#)

Historia që do t’ju tregojmë kalon çdo kufij të imagjinatës. Se unë, kur e plas bombën, e plas. Çfarë...

INVESTIGIME 18 Shtator22:05

[Pesë muaj pa të birin/ Nëna kërkon zbatimin e vendimit të gjykatës](#)

Në shumë raste, ndarja e një çifti me fëmijë të mitur shoqërohet me konflikte, përplasje e drama që godasi...

INVESTIGIME 18 Shtator21:39

[TEC-et lundruese dhe mbetjet e rrezikshme/ KESH paguan edhe për trajtimin e mbetjeve të “Tigrave”](#)

Dy TEC-et lundruese “Tigri 1” dhe “Tigri 3”, të ankoruara në zonën e Triportit në Vlorë, nuk kanë qenë...

INVESTIGIME 18 Shtator21:26

[“Ministrja kopjace”/ Klodiana Spahiu në krye të Shëndetësisë, punimi i diplomës rezulton plagjiaturë](#)

Të mërkurën e 2 shtatorit 2026, zonja Evis Sala dha dorëheqjen nga posti i ministres së Shëndetësisë. E cilësuar ...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafigas, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

INVESTIGIME 31 Maj13:33

[Gratteri për Piranjat: Mafia shqiptare ortake me Ndrangheta kalabreze](#)

Në intervistën për Piranjat, Nicola Gratteri paralajmëron se mafia shqiptare po forcon pozitat e saj në Europë, veçanëum...

INVESTIGIME 31 Maj13:12

[Gratteri për Piranjat: Kullat në Tiranë tregues i riciklimit](#)

Kryeprokurori italian i antimafigas, Nicola Gratteri, në një intervistë ekskluzive për Piranjat, ngre dyshime të forta mbi burimin e i...

INVESTIGIME 31 Maj11:50

[Katër nëna në kërkim të fëmijëve/ Bisedat që zbuluan rrjetin e errët](#)

Prej tre javësh Piranjat kanë sjellë rrëfimin e 4 nënave nga qyteti i Durrësit të cilat të alarmuara kërkonin kthimi...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 18 Shtator

["Nëna e fëmijëve të mi, dashuria ime sot na la"...](#)

Loer Kume, deputet i Partisë Socialiste për Durrësin dhe prozator e eseist i njohur, ka njoftuar mesditën e kësaj të premte ndar...

BOTA 18 Shtator

[VIDEO dramatike/ Të dashurës i erdhi burri, i r...](#)

Ky është momenti kur një burrë, gjysmë i zhveshur, u rrëzua nga një dritare teksa tentonte të arratisej, pasi dyshohet s...

AKTUALITET 18 Shtator

[Kush është 42-vjeçarja nga Durrësi që u përplas...](#)

Një ngjarje tragjike ka ndodhur mëngjesin e së premtes në San Donà di Piave, pranë Venecias, ku një 42-vjeçare shqip...

INVESTIGIME 19 Shtator13:55

[TEC-et lundruese dhe mbetjet e rrezikshme/ KESH paguan edhe për trajtimin e mbetjeve të "Tigrave"](#)

Dy TEC-et lundruese "Tigri 1" dhe "Tigri 3", të ankoruara në zonën e Triportit në Vlorë, nuk kanë qen&eu...


video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.